

Znj. Jetmira Rragami është diplomuar “Juriste” në vitin 2003, në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti “Luigj Gurakuqi”, Shkodër. Në vitin 2004 është pajisur me licencën e avokatisë. Në vitin 2008 ka përfunduar studimet “Master” pranë Departamentit të së Drejtës Civile, Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës. Në vitin 2018 ka përfunduar, po pranë këtij Universiteti, studimet doktorale dhe aktualisht mban gradën shkencore “Doktor”. Karriera e saj profesionale ka nisur në vitin 2004 dhe deri në vitin 2008 ka ushtruar detyrën si specialiste/juriste në zyrën juridike pranë OSHEE-së (KESH/DVSH), Shkodër dhe njëkohësisht si pedagoge e jashtme në Fakultetin e Drejtësisë, USH “Luigj Gurakuqi”. Nga tetori i vitit 2008 deri në gusht të vitit 2014, znj. Rragami është punësuar si pedagoge e brendshme dhe më pas përgjegjëse e Departamentit të së Drejtës Publike, pranë Universitetit privat “Kristal”. Më tej, ajo ka punuar në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, në pozicionin e jurists në Drejtorinë Juridike, në Sektorin e Përafrimit të Legjislacionit. Ka qenë pjesë e grupit të punës për hartimin e dispozitave zbatuese të ligjit 102/2014, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”. Ka kryer një sërë trajnimesh brenda dhe jashtë vendit, si dhe është autore dhe bashkautore e një sërë artikujsh të botuar në revista kombëtare dhe ndërkombëtare. Fushat e interesit janë kryesisht në të drejtën e krahasuar dhe në të drejtën tregtare. Zotëron gjuhën angleze, italiane, si dhe ka njohuri të gjuhës frënge. Nga shkurti i vitit 2018, ka ushtruar detyrën e Këshilltares ligjore pranë Njësisë Ligjore në Institucionin e Komisionerëve Publikë.

Nga janari 2025, është pjesë e Njësisë Ligjore pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit, me detyrën Këshilltare Ligjore.